



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:029633
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05441886

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, në çështjen kontestimore të paditësit V.I., nga Gjakova, fshati ..., të cilën me autorizim e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - DKA, me objekt kontesti: kompensim i shpenzimeve të ushqimit, jashtë shqyrtimit, me 12 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia, e udhëhequr sipas shenjës 2023:029633, e datës 25.01.2023, e paraqitur nga paditësja V.I., nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - DKA, me objekt kontesti: kompensim i shpenzimeve të ushqimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit të saj, me datë 25.01.2023 ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - DKA, për kompensim të shpenzimeve të ushqimit.

I autorizuari i paditëses me datë 05.03.2024, ka paraqitur parashtresë me të cilën e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë lëndore ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA.

Gjykata duke u bazuar në parashtrësën e dorëzuar për tërheqjen e padisë, si dhe në kuptim të nenit 261 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (tutje LPK), në të cilin është paraparë se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*, vendosi që konstatoj të tërhequr padinë e paditëses, nisur edhe nga fakti se e paditura deri me tani nuk ka qenë e njoftuar me padinë si dhe nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ashtu që vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 261 paragrafi 1, e në lidhje me nenin 387 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2023:029633, me 12 mars 2024

GJ Y Q T A R

Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa,
konform nenit 261 paragrafi 4 të LPK-së.